



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

Prishtinë, 18 korrik 2008

Për: Zt. Hashim Thaçi
Kryeministër i Kosovës

Kopje: Zt. Ahmet Shala
Ministër i Ekonomisë dhe Financave

Zt. Nenad Rasic
Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale

Subvencionimi i Rasteve Sociale për Shërbimet e Ujësllësit dhe Mbeturinave

I nderuari zt. Kryeministër,

Qëllimi i kësaj letre është që të shqyrtohet çështja e **subvencionimit të konsumatorëve të cenueshëm (rasteve sociale)** dhe të kërkohet nga JU konfirmimi për subvencionimin ose jo nga buxheti i Kosovës të shpenzimeve për shërbimet e ujësllësit dhe mbeturinave për kategorinë e rasteve sociale.

Kjo për faktin se, me nenin 10.3 (f) të Ligjit Nr.03/L-086 Mbi Ndryshimin e Rregullores 2004/49 Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësllësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave, është përcaktuar se "*është përgjegjësi e institucioneve të Kosovës, jo e ofruesve të shërbimeve, për të ndihmuar konsumatorët me të ardhura të ulëta që të paguajnë faturat e tyre*".

Aktualisht, Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM), në pajtim me përgjegjësitë e veta që dalin nga Ligji Nr. 03/L-086, është duke zhvilluar procesin e përcaktimit të tarifave për shërbimet e ujësllësit dhe për shërbimet e mbeturinave. Ky proces është planifikuar të finalizohet në fund të tetorit të këtij viti kur do të aprovohen tarifat e reja për këto shërbime të cilat do të aplikohen prej 1 janarit 2009.

Prandaj, për ZRRUM është me rëndësi të ketë informacion nga Ju se a do ta subvencionojë Qeveria e Kosovës pagesën për shërbimet e ujësllësit dhe mbeturinave për këtë kategori të popullatës prej 1 janarit të vitit 2009, meqenëse kjo ka impakt të drejtëpërdrejtë në lartësinë e tarifave që do ti përcaktojë ZRRUM. Kjo për arsye se, nëse nuk subvencionohet pagesa e faturave për rastet sociale, atëherë mospagesa e konsumatorëve që janë raste sociale do të ndikojë në ngritjen më të madhe të tarifave të cilat duhet ti paguajnë konsumatorët tjerë në mënyrë që të sigurohet mbulimi i kostove të kompanive publike që ofrojnë këto shërbime.

Sipas vlerësimeve të ZRRUM, vlera e nevojshme e mjeteve për subvencionimin vjetor të pagesës së faturave të ujësjellësit dhe mbeturinave për rastet sociale, është **rreth 2.5 milion EUR**. Kjo vlerë supozon pagesën e sasisë prej 20 m3 ujë për një familje (që paraqet konsumin prej 100 litra në ditë për një banorë) si dhe pagesën e plotë të faturës për shërbimet e mbeturinave.

Sidoqoftë, ZRRUM është në dispozicionin tuaj dhe të Ministrive përkatëse për të diskutuar më hollësisht lidhur me këtë çështje në një takim eventual që do të organizohet për këtë qëllim.

Duke pasur parasysh kalendarin e përcaktimit të tarifave, unë do të ju isha shumë mirënjohës nëse do të na e konfirmonit qëndrimin e Qeverisë për subvencionimin ose jo të pagesës së faturave për rastet sociale deri më **1 shtator 2008** në mënyrë që ZRRUM të jetë në gjendje të procedojë me përcaktimin e tarifave dhe të marrë vendimin për këto tarifa deri më **31 tetor 2008** sipas dinamikës së planifikuar.

Unë besoj se kësaj çështje do ti kushtoni vëmendjen e duhur dhe shpresoj që përgjigjja e juaj do ta konfirmojë subvencionimin e këtyre shërbimeve për kategorinë e rasteve sociale duke pasur parasysh rëndësinë jetike që kanë shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave për popullatën (jo më pak të rëndësishme se sa shërbimet e energjisë elektrike që aktualisht i subvencionon Qeveria) si dhe implikimet eventuale të mos-subvencionimit në ngritjen e tarifave.

Në fund dëshiroj të ju njoftoj se kjo letër dhe përgjigjja e juaj do të botohet në ueb-faqen e ZRRUM-it.

Me respekt,



Afrim Lajçi

Drejtor i ZRRUM